



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 147, Datë 24.04.2023

MBI

**DHËNIEN E AUTORIZIMIT NGA ERE PËR VENDOSJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “SPV BLUE 1” SH.P.K. SI MJET (BARRË SIGURUESE) PËR GARANTIMIN E DETYRIMIT NDAJ “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIV”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 5, 8, 9, pikat 4 dhe 5, dhe 10 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve të ortakut/aksionerit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 235, datë 26.11.2021; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.04.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1134/1 prot., datë 20.04.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguruese) për garantimin e detyrimit ndaj “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIV”,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1134 prot., datë 27.03.2023, ka paraqitur kërkesën për dhënie autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet (barrë siguruese) për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIV”.
- Shoqëria është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 116, datë 24.05.2022.
- Rezulton se shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., plotëson kërkesat si vijon:
  - **Neni 8, pika 1**, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
  - **Neni 8, pika 2**, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”.
- Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, rezulton se shoqëria ka plotësuar tërësisht dokumentacionin e kërkuar në nenin 8, pika 1 dhe 2 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie autorizimit nga ERE për ndryshimin e statusit ligjor të të licencuarit, ndryshimin e ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit dhe vendosjen e kuotave/aksioneve

të ortakut/aksionarit që kontrollon interesat e të licencuarit si mjete për garantimin e përmbushjes së detyrimit/eve ndaj të tretëve”.

- Shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k. ka shlyer të gjitha detyrimet ndaj ERE-s për sa i përket pagesave rregullatore.
- Kontrata e nënshkruar me MIE-n Nr. 2720 Rep, Nr. 2066 Kol, datë 09.07.2021, e depozituar në ERE nga shoqëria “SPV BLUE 1” sh.p.k., në kuadër të licencimit në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nuk përmban detyrimin për miratimin/njofimin e autoritetit shtetëror për shoqërinë, por si dhe në raste analoge, ERE do të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, në cilësinë e organit shtetëror të autorizuar në lidhje me dhënien e këtij autorizimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të shoqërisë “SPV BLUE 1” sh.p.k. si mjet (barrë siguroese) për garantimin e detyrimit ndaj “GREEN FOR GROWTH FUND SOUTHEAST EUROPE S.A., SICAV-SIV”.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “SPV BLUE 1” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**